



Datë: 22.07.2025
Numër Protokolli: 5313/2025

A.nr.707/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.707/2025, të datës 23.04.2025, të parashtruar nga ankuesi B.A, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Shkelqim Jakupi, nga Fushë Kosova, kundër organit të punësimit-Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike “*ndërprerje e marrëdhënies së punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 22.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.707/2025, e datës 23.04.2025, e parashtruar nga ankuesi B.A.

II. Anulohet Vendimi me numër protokolli 1-319/02-KOM, i datës 14.04.2025, i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

III. Obligohet Zyrtari Kryesor Administrativ i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për zbatimin e këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke e kthyer ankuesin në vendin e punës sipas Ndryshim dhe plotësimit të Aktit të emërimit të datës 20.01.2017, duke ia kompensuar pagën në mënyrë retroaktive dhe at që nga data e ndalimit të saj deri në zbatimin e këtij vendimi me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej saj.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për ndërmarrjen e veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, B.A (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), përmes përfaqësuesit të autorizuar Avokatit Shkelqim Jakupi, më datë 23.04.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 1-319/02-KOM, të datës 14.04.2025, të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 12.05.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa kjo e fundit më datë 15.05.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së Kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 3816/2025 të datës 05.06.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesi edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave(në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit), **ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit 2690/2025, të datës 23.04.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dokument identifikimi i ankuesit; Autorizimin; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit të datës 20.01.2017 dhe përshkrimin e detyrave të punës; Vendimin me numër protokollit 1-319/02-KOM, të datës 14.04.2025; Vendimin OSHP:2024/0992 të datës 20.12.2024; E-mailin e datës 23.12.2024; E-mailin e datës 26.12.2024; E-mailin e datës 06.01.2025; E-mailin e datës 27.12.2024; E-mailin e datës 14.01.2025; Kërkesën për incimin e procedurës disiplinore me numër protokollit 1-29/02 të datës 14.01.2025; E-mailin e datës 15.01.2025; E-mailin e datës 17.01.2025; Vendimin me Nr.309/02 i datës 10.04.2025; Vendimin me Nr.154/02 i datës 21.02.2025; E-mailat e datës 08,10,11.04.2025; Vendimin me numër protokollit 1-163/02-KOM i datës 27.02.2025; E-mailin e datës 15.04.2025 dhe 17.04.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 12.05.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 15.05.2025; Vendimet për themelimin e Komisioneve Disiplinore të MINT; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit të datës 20.02.2020; Akt emërimit AE.Nr.35/2024 të datës 26.02.2024; Akt emërimit AE.Nr.38/2024 të datës 26.02.2024; Vendim Ref.Nr.01/64 të datës 10.10.2024; Vendimin Ref.02/Nr.23 të datës 04.02.2025; Vendimin Ref.02/Nr.302 të datës 06.12.2024; Procesverbalet e Komisionit Disiplinor të datës 11.04.2025 si dhe të datës 25.02.2025; E-mailin e datës 11.04.2025; E-mailin e datës 04.11.2024; E-maili i datës 14.01.2025; Vendimin me Ref.Nr.01/74 të datës 04.11.2024; Përgjigjen e datës 25.02.2025; Vendimin me Ref.12 nr.43 të datës 11.06.2024; Vendimin Ref.12.Nr.23 të datës 06.03.2023; E-mailat për ekspertizat e OSHP; Shkresa të nxjerra nga E-prokurimi; Vendimin Ref.Nr.68 të datës 18.07.2024; Shkresë e datës 29.10.2024; Raportin e ekspertit të shqyrtimit të lëndës Nr.2024/0992; Raportin e ekspertit të shqyrtimit të lëndës 2024/0999; E-mailin e datës 26.02.2025, lidhur me plotësimin e dosjes nga ana e inicueses së procedurës disiplinore; Kërkesën me numër protokollit 1-616 të datës 31.05.2024; Vendimin me numër protokollit 6524/03 të datës 20.12.2024;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e bazuar, **sepse:**

Kolegji i Këshillit, nga administrimi i shkresave të lëndës konstaton se ankuesi sipas Ndryshim dhe plotësimit të Aktit të emërimit të datës 20.01.2017, është i punësuar në pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit*, në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Tutje, Ushtruesja e Detyrës e Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, pas pranimit të e-mailit të datës 06.01.2025, të Ushtruesit të Detyrës të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve të Kosovës (KIESA), lidhur me shqetësimet që lidhen me projektet e parqeve industriale, e njëjta në cilësi të mbikëqyrëses së

drejtpërdrejtë të ankuesit, me datë 14.01.2025, përmes kërkesës me numër protokolli 1-29/02 ka bërë iniciimin e procedurës disiplinore ndaj tij pranë Komisionit Disiplinor, mbi supozimet për shkelje disiplinore sipas nenit 56 paragrafit 4, nën paragrafit 4.1, 4.2 dhe 4.5 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht mbi pretendimet për neglizhim të punës duke mos reflektuar për t'i mbrojtur interesat e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësive dhe Tregtisë, për projektet kapitale të KIESA-së.

Ndërsa, Komisioni Disiplinor i organit përkatës të punësimit, me Vendimin me numër protokolli 1-319/02-KOM, të datës 14.04.2025, ka konstatuar se ankuesi ka bërë shkelje të rënda të detyrave dhe përgjegjësisë të punës, të parapara sipas Nenit 56 paragrafi 4 nën paragrafit 4.1 dhe 4.5 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, dhe rrjedhimisht të njëjtit i shqipton masën disiplinore *“largimi nga shërbimi civil”*, sikurse përcaktohet me nenin 57 paragrafi 2 nën paragrafi 2.7 të këtij ligji.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Vendimi me numër protokolli 1-319/02-KOM, të datës 14.04.2025, i Komisionit Disiplinor të organit përkatës të punësimit, është nxjerrë mbi shkelje të parimeve të përgjithshme të LPPA-së dhe Detyrimeve të LZP-së, shkeljeve të procedurave administrative dhe disiplinore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljeve të ligjit material, andaj kërkon aprovimin e ankesës si të bazuar, anulimin e vendimit kontestues, me obligimin që organi i punësimit ta kompensoj të njëjtin me pagat e pa paguara në mënyrë retroaktive, deri në ditën e ekzekutimit të vendimit.

Kolegji i Këshillit, nga të dhënat zyrtare konstaton se pozita e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësive dhe Tregtisë, është e mbuluar me Ushtrues Detyre, që nga data 25.02.2020 deri më 22.06.2020, dhe nga data 10.09.2020 e tutje, rrjedhimisht edhe deri në datën kur ndaj ankuesit është iniciuar kërkesa për procedurë disiplinore dhe të njëjtit i është shqiptuar masa disiplinore. Ndërsa, pozita e Ushtruesit të Detyrës të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve të Kosovës (KIESA), mbulohet me Ushtrues Detyre, që nga data 20.01.2022, ku si rrjedhojë z .Z.D, përmes Vendimit me numër protokolli 259 të datës 20.01.2022, nga pozita Udhëheqës i Divizionit për Politika Tregtare në Departamentin e Tregtisë, është caktuar në këtë pozitë nga Ministria e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësive dhe Tregtisë.

Rrjedhimisht, në vështrim të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik gjegjësisht neni 40 paragrafi 9, 10, dhe 11 ku përcaktohej se: 9. *Në rast se procedura e konkurrimit përfundon pa të paktën dy kandidatë fitues të vlerësuar me më shumë se 70 për qind të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, organizohet një procedurë e dytë konkurrimi. Procedura e dytë e konkurrimit është e hapur dhe në të mund të marrë pjesë çdo kandidat, që i plotëson kërkesat e përgjithshme për pranimin në kategorinë e lartë drejtuese dhe kërkesat e posaçme për pozitën përkatëse nga brenda apo jashtë Shërbimit Civil.* 10. *Në rast se edhe procedura e dytë nuk sjell të paktën dy fitues, një procedurë e tretë konkurrimi, gjithashtu e hapur, organizohet pas një periudhe 3 (tre) mujore.* 11. *Pas dështimit të procedurës së dytë, deri në plotësimin e pozitës, detyrat e pozitës së lirë kryhen nga nëpunësi i kategorisë së mesme drejtuese me përvojë më të gjatë në Shërbimin Civil të institucionit përkatës;*, pra sipas kësaj dispozite ligjore që ka qenë në fuqi deri me datë 25.09.2023, kur ligji Nr.06/L-114 është shfuqizuar neni 104 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Kolegji konstaton se sipas dispozitës së lartshënuar nuk ka pasur kufizim kohor lidhur me ushtrimin e pozitave të larta drejtuese. Ndërsa, pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, çështja e emërimit dhe mandatit në cilësinë e ushtruesit të detyrës, është përcaktuar sipas nenit 35 të këtij ligji, gjegjësisht mbajtja e pozitave më ushtrues detyre tani më rregullohet ndryshe dhe atë si vijon: *Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë*

drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë. 2. Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit. 3. Zyrtarja/i publik nuk mund të caktohet si ushtruese/i detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) muaj, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë. 4. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se afati i përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni. 5. Çdo vendim i marrë nga ushtruesja/i i detyrës, pas kalimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni, është i paligjshëm.

Në këtë kontest, Kolegji i Këshillit, ka marrë parasysh Aktgjykimin e Gjykatës Supreme P.A.nr.07/2025 të datës 10.06.2025, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 03.07.2025 cili në faqen nr.10 të tij ka trajtuar, nenin 35 të Ligjit Nr.08/L-198 për Zyrtarët Publik, rrjedhimisht Gjykata Supreme, me këtë rast ka konstatuar se: “ ***Nga kjo dispozite rrjedhë qartë se çdo akt juridik i nxjerrë nga një udhëheqës në cilësinë e ushtruesit të detyrës pas skadimit të afatit prej një viti është i pavlefshëm në thelb, për shkak të mungesës së kompetencës ligjore për të ushtruar funksionet që burojnë nga ajo pozitë..... Ligji i referohet pozitës si funksion institucional dhe jo individit si person. Pra ndërrimi i personit nuk e dhe nuk e rifillon afatin gjashtëmuajor, përkatësisht njëvjeçar të ushtrimit të përkohshëm të pozitës. Kjo qasje është në përputhje me frymën e ligjit që kërkon, stabilitet, profesionalizëm dhe përgjegjësi në udhëheqjen publike..., Gjykata konstaton se pretendimet e palës paditëse për tejkallim afati janë të bazuar në dispozitat eksplicite ligjore dhe kanë për qëllim mbrojtjen e legjitimitetit të aktit dhe sigurinë juridike në funksionimin e institucioneve. Respektimi i Kufizimeve kohore është thelbësore për funksionimin ligjor dhe transparent të institucioneve publike. Çdo shkelje e këtyre normave sjell pasoja negative në zbatimin e drejtë të ligjit dhe mund të krijojë precedent të dëmshëm. Kështu, pretendimet e palës paditëse gjejnë mbështetje në parimet e ligjshmërisë dhe rendit kushtetues, të cilat i mbështet dhe i konstaton edhe gjykata.”***

Andaj, në këtë kontest meqenëse Aktgjykimet e Gjykatave janë të obliguar për të gjithë subjektet e së drejtës, nisur nga neni 101 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës ku përcaktohet se “ ***Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe i cili pasqyron diversitetin e popullit të Republikës së Kosovës***”, si dhe Gjykata Supreme gjatë shkrimit të aktgjykimit ka shkruar në trajtën e shumës, që do të thotë se aktgjykimi nuk rregullon kontestin vetëm në mesë palës paditës dhe të paditurës (palë paditës: nëpunësit të Autoritetit të Aviacionit civil dhe paditura: AAC), por gjen shprehje në të gjitha institucionet që zbatojnë Ligjin Nr.08/L-198 për Zyrtarët Publik, Kolegji i Këshillit rithekson faktin se institucionet e administratës publike janë të obliguar ta zbatojnë Ligjin Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme për aq sa nuk është e rregulluar ndonjë procedurë me ligj të veçanta (në rastin konkret çështja është e përcaktuar në nenin 35 të LZP), si rrjedhojë e këtij konstatimi të nxjerrë nga konstatimi i Aktgjykimit P.A.nr.07/2025, dhe pasqyrimin si më sipër se mbajtja e pozitave të iniciuesve e procedurës disiplinore, gjegjësisht pozitës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve të Kosovës (KIESA), në cilësi të Ushtruesve të Detyrës ka tejkalluar afatet ligjore të përcaktuara nga neni 35 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ndaj Kolegji i Këshillit, me këtë rast konstaton se Vendimi me numër protokolli 1-319/02-KOM, i datës 14.04.2025, i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që është nxjerrë si pasojë e veprimeve, gjegjësisht e-mailit të datës 06.01.2025 dhe kërkesës me numër protokolli 1-29/02 të datës 14.01.2025, nga mbajtësit e këtyre pozitave drejtuese jashtë afatit ligjor të kompetencës, është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se : ***1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:***

1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme, apo 1.7. nuk është në pajtim me parimin e proporcionalitetit.

Kolegji i Këshillit, marrë parasysh konstatimet si me sipër, nuk është lëshuar edhe në qështje tjera që ndërlidhen me këtë objekt të kësaj ankese, për faktin e pa kontestueshëm se nuk mund të ndryshoj përmbytjen si në dispozitiv të këtij vendimi, rrjedhimisht duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit me qëllim të kthimit të ligjshmërisë vendosi për aprovimin e ankesës si të bazuar dhe anulimin e Vendimit me numër protokolli 1-319/02-KOM të datës 14.04.2025, të Komisionit Disiplinor të organit përktës të punësimit, me obligimin ligjor që Zyrtari Kryesor Administrativ i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ankuesin ta kthejë në vendin e tij të punës sipas Ndryshimit dhe plotësimit të Aktit të emërimit të datës 20.01.2017, duke ia kompensuar pagën në mënyrë retroaktive që nga data e ndalimit të saj e deri në zbatimin e këtij vendimi me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej saj, ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore masën e shqiptuar disiplinore duhet ta largojë nga dosja personale e ankuesit.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.707/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit, Avokatit Shkelqim Jakupi;
- Organit të punësimit: Zyrtarit Kryesor Administrativ dhe Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.